

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Optimize Consulting Services ” SHPK

Sot, më datë 05/08 /2023 ortakët themelues:

1. **Z. Marjus Gjika** shtetas shqiptar, i biri i Maksim dhe Engjëllushe, lindur në Vlorë, i datelindjes 14.03.1986, me banim në adresën: rruga „ Dalip Zavalani” Nd.15. H.1 , person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal I603141031.

Kanë vendosur themelimin e shoqërisë “Optimize Consulting Services” SHPK me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare “Optimize Consulting Services” SHPK themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë Shoqëria). Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2.

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj “Optimize Consulting Services” SHPK.

NENI 3.

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtem:

1. Shoqëria ka për objekt ofrimin e këshillimit ligjor dhe të biznesit, këshillimit të karrierës dhe ndërmjetësimin në punësim, administrimit dhe ndërmjetësimin të pasurive të paluajtshme, dhe të tjera, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
2. Shërbime këshillimore që lidhen me emigrimin.

Shoqëria, brenda kufijve të parashikuara nga legjisllacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Optimize Consulting Services
AKT THEMELIMI



Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj duke u bazuar tek lejet, licencat, aprovimet apo autorizimet e tjera të ligjshme të lëshuara nga institucionet qeveritare kompetente të fushës.

NENI 4. Selia e Shoqërisë

4.1 Selia Qëndrore e Shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresen: "Hoxha Tahsim" pallatet Vjetro K.2 Hyrja 2. . Adresa e selise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

4.2 Seli e shoqërisë në Elbasan : Lagjia "Kala" rruga "Rinia" Nr.53.

4.3 Seli e shoqërisë në Korçë: Rruga "Ligor Rembeci", Serenity Residence 2

NENI 5. Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në lekë.

Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej -100.000(njeqindmije) Lekë, i ndare në 1(nje) kuota .

Ortakët themelues të shoqërisë, i zotërojnë kuotat në shoqëri si më poshtë:

- **Marjus Gjika** Zotërues i 1(një) kuote që përfaqson 100% te kapitalit të shoqërise me vlerë 100.000(njeqindmije)lek.

Kapitali themeltar është derdhur tërësisht nga ortakët themelues. Vlera dhe pagesa e e kapitalit themeltar do të kryhet në momentin e nënshkrimit të këtij statuti dhe aktit të themelimit.

NENI 6. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të pacaktuar.

Neni 7. Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve - organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.



Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administrator i parë i shoqërisë do të jetë vet ortaku i vetëm i saj, Marjus Gjika - shtetas shqiptarë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I603141031, me një mandat 5 (pese) vjeçar.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Eskperti kontabël

Ekspërti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përputhje me me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.

NENI 9

Ndryshimi i objektit

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Zgjerimi i shoqërisë

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ruajtja e sekretit dhe shkaktimi i dëmit

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduajnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12.

Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët themelues dhe i vulosur përpara noterit, në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

NENI 13.

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Optimize Consulting Services
AKT THEMELIMI



Mosmarrvëshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve apo ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 14.
Dispozita Përfundimtare

Akti i themelimit përpilohet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

1. MARINA GJIKU


